



### KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot më datën 22.08.2000 (dymije), në zyren e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Myrvete PËRMETI, ndërmjet:

- a) **Dritan Hoxha**, i biri i Fiqiriut, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Nr. 0161795,(në vazhdim e quajtur "Shitesi").
- b) **Perikli KARAVELLA**, lindur në Kavaje më 26.12.1956, banues në Rr."Xhorxh Bajron", Nr.54/4 Laprake Tirane, mbajtës i pasaportes Nr. 0263078,madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, (në vazhdim i quajtur "**Blerësi**").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. **Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të 660 (gjashtëqind e gjashtedhjetë) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili. Këto aksione përfaqësojnë 33% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime pa oferte publike "**TELEVIZIONI ARBERIA**"sh.a,me emr te shkurtuar **TV.A.**, shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, rregjistruar si person juridik ne Gjykatën e rrethit Tirane Nr.22058 date 04.10.1999.
2. **Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të aksioneve të sipërpërmendura, pra të 660 (gjashtëqind e gjashtedhjetë) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili, që përfaqësojnë 33% të kapitalit aksioner të shoqërisë "**TELEVIZIONI ARBERIA**"sh.a, me emer te shkurtuar **TV.A.**, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre **Blerësit ne shumen 660.000 leke**. Pagesa e vlerës së aksioneve të mësipërme eshte shlyer nga ana e **Bleresit**.Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në rregjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të Shoqërisë "**TELEVIZIONI ARBERIA**"sh.a,me emer te shkurtuar **TV.A.**,
3. **Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
4. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.
5. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe

posedimit të plotë, ka të drejtë ti zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. Blerësi ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

6. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë hartohet në kater (4) origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, një kopje mbahet nga Noteri Publik dhe një kopje depozitohet në Gjykatë, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

### PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

1- Dritan Aloshu

BLERËSI

2 PERIKLI KARAVELLA

NOTERI

NOTERE  
MYRVETË PERMEPI

12.05.2018